



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:006921
Datë: 28.03.2024
Numri i dokumentit: 05515606

AC.nr.7795/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Feka-Kryetar i Kolegjit, Frosina Sylejmani dhe Arsim Hamzaj, në çështjen juridiko kontestimore të paditësve – F. K.i, E. K., E. K., L. K., H.B. që të gjithë nga fsh. P. K-P., të cilët i përfaqëson sipas autorizimit Av. S. A. nga P., rr xxxxx, kundër të paditurve K. e S. “I.” me seli në P., rr. xxxx, A. (M.) M. dhe M. M. që të dy nga P. rr xxxx xxxx me bazë juridike: kompensim dëmi me vlerë kontesti 20.000 euro, duke vendosur sipas ankesës së ushtruar nga i padituri i tretë M.M. nga P., kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm me numër C.nr. 1055/22, datës 17.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datës **26.03.2024**, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

I.REFZUOHET SI E PA BAZUAR ankesa e të paditurit të tretë M. M. nga P., ndërsa, Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, me numër C.nr.1055/22, i datës 17.10.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm me aktvendimin e ankimuar, C.nr.1055/22, dt: 17.10.2023, duke vendosur lidhur me afatshmërinë e ankesës së ushtruar nga i padituri i tretë, nxjerr aktvendimin si në vijim:

HEDHET si e pasafatshme ankesa e të paditurve A. (M.) M. dhe M. M. që të dy nga Peja rr xxxx, ushtruar kundër Aktvendimit C.nr. 1025/22, të datës 08.08.2023.

Kundër këtij aktvendimi, pas skadimit të afatit të paraparë ligjor, ankesë ka ushtruar i padituri i tretë M. M. nga Peja, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit, aktvendimin e ankimuar ta prishë dhe çështjen ta kthej ne rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në ankesë nuk është ushtruar nga pala paditëse.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe në kuptim të nenit 194, 208 dhe 209, pika b) të LPK-se, gjeti se:

Ankesa e të paditurit të tretë M. M. nga P., është e pa bazuar.

Gjykata e Apelit, nga shkresat e lëndës, vërteton se gjykata e shkallës së parë, pas kthimit të lëndës në rigjykim, duke vepruar sipas udhëzimeve të gjykatës së shkallës së dytë, sipas propozimit të palës paditëse, ka vazhduar procedurën e ndërprerë kontestimore në këtë çështje juridike, sipas aktvendimit C.nr. 1617/19 të dt. 16.10.2020, ku të njëjtin aktvendim këtu të paditurëve A. dhe M. M. të dy nga Peja, aktvendimin e gjykatës për vazhdim të procedurës kontestimore, konstatohet se e kanë pranuar me datën 15.08.2023, ndërsa i padituri i tretë M. M. (ngase në ankesën e ushtruar si parashtrues i ankesës evidentohet vetëm i padituri i tretë M. M.), e ka ushtruar me datën 07.09.2023, dhe nisur nga kjo, gjendje e vërtetuar, sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së dytë, gjykata e shkallës së parë, duke u kujdesur sipas detyrimit të saj zyrtar për lejueshmërinë dhe afatshmërinë e ankesës së ushtruar konform nenit 186 par.1 dhe 2 të Ligjit për Procedurë Kontestimore, drejtë ka vepruar kur ka hedhë poshtë si të palejueshme (pas afatshme), ankesën e këtu të paditurit të tretë M. M., ngase e njëjta është ushtruar pas kalimit të afatit ligjor për ushtrimin e saj dhe atë, konkretisht e njëjta ankesë është ushtruar ditën e 23 nga data e pranimit të aktvendimit të ankimuar për vazhdimin e procedurës.

Gjykata e Apelit, nga përmbajtja e ankesës së ushtruar nga i padituri i tretë konstaton se i njëjti në ankesë pretendon edhe aspektin material të çështjes, respektivisht pretendon se i njëjti nuk ka qenë fare pjesë e aksidentit të komunikacionit nga i cili paditësit kërkojnë kompensimin e dëmit, megjithatë në këtë fazë të procedurës, përderisa procedura kontestimore ka vazhduar në gjykatën e shkallës së parë, i takon të paditurit të tretë që prapësimet e tij procedurale dhe materiale lidhur me padinë e paditësve ti parashtrorj dhe argumentoj në gjykatën e shkallës së parë gjatë procedurës kontestimore, që pritet të zhvillohet në gjykatën e shkallës së parë, andaj, gjykata e shkallës së dytë, duke u kufizuar vetëm në shkeljet e pretenduara ndaj aktvendimit të ankimuar, gjeti se nga gjykata e shkallës së parë, drejtë është vendosur në rastin konkret, ngase, me nenin 176 par.1 të Ligjit për Procedurë Kontestimore nr. 03/L-006, përcaktohet afati 15 ditor për ushtrimin e ankesës kundër aktgjykimin të shkallës së parë, përveç kur me dispozita tjera në procedura të veçanta kontestimore parashihen afate më të shkurtra ligjore për ushtrimin e mjeteve juridike, meqenëse, hudhjen poshtë të ankesës nuk e ka bërë gjykata e shkallës së parë, në kuptim të nenit 186 paragrafi 1 dhe 2, të LPK-së, sipas të cilit ankesa është e pa afatshme po që se është paraqitur pas skadimit të afatit ligjorë për paraqitjen e saj, dhe meqë të njëjtën hudhje poshtë të ankesës e ka bërë gjykata e shkallës së parë në kuptim të nenit 186 par.1 dhe 2 të LPK-së, atëherë, gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se në kuptim të nenit 194, nenit 208 dhe 209, pika (b) të LPK-se, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT TË KOSOVES NË PRISHTINË
AC.nr.7795/23, dt:26.03.2024**

**Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari
Besnik Feka**